



SHKOLLA E MESME E LART PROFESIONALE E MJEKESIS "KEKA-MED"KLINË

(IAAP)

Bazuar në Rregulloren e Brendshme për regjistrimin e Nxënësve të SHMLP "KEKA-MED", Rregulloren e Punës së SHMLP "KEKA-MED" dhe në Statutin e SHMLP "KEKA-MED", hartohet dokumenti mbi Procedurat për Regjistrimin e Nxënësve.

PROCEDURAT PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE

Klinë, 2014

PROCEDURAT PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE

DISPOZITAT E PERGJITHSHME

Me kete rregullihet e drejta per regjistrim, shpallja e konkursit, procedurat e regjistrimit si dhe nënshkrimi i kontratës

Të drejtë për t'u regjistruar kanë:

- Shtetasit e Republikës së Kosovës, të gjithë të rinjtë dhe të rejat të cilët kanë përfunduar me sukses arsimin e detyruar nëntëvjeçar, janë në



moshë deri 17 vjeç dhe zotërojnë aftësi shëndetësore (fizike e mendore) të mjaftueshme për të kryer këtë nivel shkollimi:

- Kandidatët me aftësi të kufizuar duke u bazuar në Rregulloren e SHMLP "KEKA-MED" për Organizimin e Arsimit Gjithëpërfshirës për fëmijët me Nevoja të Veçanta Arsimore;
- Të drejtë për t'u regjistruar kanë edhe shtetasit e huaj, sipas kushteve dhe mënyrës së rregulluar me Ligjin për Arsim dhe Aftësim Profesional në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 22/2013, me Statutin e SHMLP "KEKA-MED" dhe me rregulloren e Brendshme për Regjistrimin e Nxënësve, e SHMLP "KEKA-MED".

Shpallja e Konkursit

- Regjistrimi i nxënësve bëhet në bazë të konkursit publik, të cilin e shpall Drejtori i Shkollës;
- Me konkurs përcaktohen drejtimet, profesionet, paralelet, numri i nxënësve, gjegjësisht kriteret dhe mënyra e regjistrimit të nxënësve;
- Konkursi parasheh një test të brendshëm me shkrim (test i pranimit);
- Konkursin për regjistrimin e nxënësve e realizojnë komisionet përkatëse;
- Komisioni për regjistrimin e nxënësve shpall listën e kandidatëve të pranuar dhe të refuzuar;
- Kandidati i refuzuar ka të drejtë t'i paraqes ankesë shkollës brenda 3 ditëve, nga dita e shpalljes së rezultateve;
- Drejtori i shkollës brenda 5 ditëve merr vendim lidhur me kundërshtimin e kandidatit të refuzuar.

Procedurat e Regjistrimit

- Pas shpalljes së rezultateve, nxënësit të cilët kanë kaluar me sukses kriteret e pranimit, ftohen së bashku me prindin apo një person kujdestar, për të nënshkruar Kontratën e regjistrimit;
- Nxënësi duhet të ketë me vete:
 - Diplomën e shkollës fillore;
 - Dëftesat e shkollës fillore
 - Certifikatën e lindjes;
 - Dy fotografi;



- Aplikacionin (merret në SHMLP "KEKA-MED")

Keshili i shkollës "KEKA-MED" KLINË
